



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0406

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së OE "Flurim Nebija" B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Barna nga LE" me numër të prokurimit 206-24-540-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 22/07/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Flurim Nebija" B.I. e datës 10/05/2024, me nr. 2024/0406, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Barna nga LE", me numër të prokurimit 206-24-540-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 31.01.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Barna nga LE", me numër të prokurimit 206-24-540-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera totale e kontratës së parashikuar është: 1,029,965.19€.

Ankuesi është ankuar për LOT 28 vlera e parashikuar 58,386.24euro.

Me datë 19.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar

Me 22.04.2024, OE "Flurim Nebija" B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 29.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 10.05.2024 operatori ekonomik "Flurim Nebija" B.I ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0406 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 14.05.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim: Ankesa të refuzohet si e bazuar; kurse Vendimi i atakuar i AK të mbetet në fuqi

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Flurim Nebija" B.I ne ankesën Nr. 406/24 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se: "Pas nxjerrjes se Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është vërejtur se operatori ekonomik ankues Flurim Nebija B.I. me emër tregtar N.T.T. Nini Pharm (tash e tutje referuar si: OE Ankues) nuk është shpallur fitues për LOT 28 për të cilën edhe ka ofertuar, por nga Autoriteti Kontraktues është eliminuar për shkak të: 1. Autorizimi i Prodhuesit është dhënë vetëm për sasinë 27,000.00 cope; 2. Autorizimi i prodhuesit është dhënë vetëm deri me datën 31 maj 2024; OE Ankues, me date 22 prill 2024, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, me ane të të cilit ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe aktiviteti i prokurimit 206-24-540-1-1-1 të kthehet në rivlerësim. Me date 29 prill 2024, Autoriteti Kontraktues merr vendim me ane të të cilit refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të OE Ankues dhe thekson se arsyet për refuzim të ankesës janë fakti se autorizimi i prodhuesit është dhënë vetëm për 27,000.00 njësi të produkteve si dhe autorizimi ka validitet vetëm deri me 31 maj 2024, kurse është dashur të jete

për tere kohëzgjatjen e kontratës”. Më tej Autoriteti kontraktues - Ministria e Shëndetësisë ne mënyrë te gabuar ka vlerësuar se OE Ankues nuk ka ofruar një autorizim valid te prodhuesit. “Sipas kërkesës ne piken 9.1 dhe 9.2 te Dosjes se Tenderit, theksohet qarte se kërkohet autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne tender apo nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. Ne asnjë pike nuk është theksuar se kërkohet autorizimi për implementimin e kontratës, pasiqe kërkesa ka qene vetëm për pjesëmarrje ne tender. Ne baze te Ligjit për Prokurimin Publik, pjesëmarrja ne tender nënkupton vetëm ofertimin dhe jo implementimin e kontratës, pasiqe fitimi i kontratës është rrethane e ardhshme e pasigurte. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar këtë kërkesë te Dosjes se Tenderit, sikur te behet fjale për implementimin e kontratës dhe ne mënyrë te kundërligjshme ka eliminuar OE Ankues. Për me tepër, Autoriteti Kontraktues ne mënyrë te kundërligjshme eliminon OE Ankues për faktin se ne autorizimin e prodhuesit është shënuar sasia prej 27,000.00 njësi produktesh, kurse ne dosjen e tenderit është kërkuar një numër me i larte. Edhe pse OE Ankues ka ofruar autorizimin e ri ku është shënuar shuma e plote e njërive te mallrave për tu liferuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka marre parasysh këtë fakt dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE Ankues. Autoriteti Kontraktues ka gabuar ne dy aspekte gjate refuzimit te kërkesës për rishqyrtim lidhur me këtë pike. E para, dosja e tenderit nuk e ka përcaktuar faktin se autorizimi i prodhuesit duhet te përfshije edhe numrin e njërive për te cilat duhet te sigurohet autorizimi i prodhuesit, por vetëm ka kërkuar qe autorizimi te përmbajë te drejtën për pjesëmarrje, adresën, numrin e telefonit, emailin dhe webfaqen për verifikim sa me te lehte. Te gjitha këto kritere, Autorizimi i paraqitur nga OE Ankues i ka plotësuar, por me ane te veprimeve te kundërligjshme te Autoritetit Kontraktues është eliminuar duke iu mohuar e drejta për dhënie te kontratës, edhe pse çmimi ofertues i OE Ankues ka qene me i lire se i fituesit. Se dyti, Kontrata për te cilën është ofertuar është kontrate publike kornize ku sasia është indikative, me një devijim te lejuar praj /-30%, ku sasia mund te jete me e vogël se njësitë e përcaktuara ne Dosjen e Tenderit”. Për me tepër, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues bie ndesh me Nenin 56, paragrafi 3 te Ligjit për Prokurimin Publik, ku është përcaktuar se tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonjë kërkesë ose kriteri qe nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Një interpretim i tille është poashtu i bazuar ne parimet kryesore te procedurës se vlerësimit sipas LPP, ku konform RRUOPP, gjegjësisht Nenit 41, pika 3, potencohet, vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies se kontratës te specifikuara ne njoftim për kontrate/dosje te tenderit mund te përdoren si baze për vlerësim. Ne rastin konkret, përderisa autorizimi i prodhuesit nuk është kërkuar për tere kohëzgjatjen e kontratës dhe nuk është kërkuar qe ne autorizim te shënohet sasia e caktuar e produkteve, është tërësisht e kundërligjshme mënyra se si është bere ekzaminimi i tenderëve nga ana e Autoritetit Kontraktues. Për me tepër, ne baze te nenit 59, paragrafi 4 te Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka mundur te kërkojë informata shtese nga ana e OE Ankues lidhur me dilemat te cilat i ka pasur lidhur me autorizimin e kërkuar.

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se “Sa i përket OE Fitues Liri Med Sh.P.K, duhet te theksohet se ky operator është i papërshtatshëm për tu shpallur fitues, për shkak te çmimit me te shtrenjte se OE Ankues. Poashtu, OE Fitues është gjobitur disa here nga SHSKUK ne cilësi te AK, ne shume prej rreth EUR 20,000.00 për shkak te vonesave ne liferimin e produkteve. Për me tepër, OE Fitues është ne vonese edhe ne pagimin e tatimeve pranë ATK dhe për këtë i është shqiptuar gjobe ne vlere prej EUR 388.00 nga ana e ATK, fakt qe ne baze te kërkesave te Dosjes se Tenderit, e bene te papërshtatshëm për te nënshkruar kontrate. Andaj, kërkojmë nga OSHP qe te aprovoje ankesën e OE Flurim Nebija B.I, te ktheje lenden ne rivlerësim dhe OE Ankues te shpallet fitues si operator i përgjegjshëm me çmimin me te lire te ofertuar për LOT 28”.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Flurim Nebija” B.I

Pretendimin e juaj ankimor e konsiderojmë të pa bazuar, duke marrë parasysh se në ofertën tuaj keni ofertuar me autorizim nga prodhuesi për sasinë e kufizuar 27,000 njësi, ndërkohë që sasia e parapare në tender ka qenë 27,936. Në letrën e dërguar me ankese për amendamentimin e autorizimit, afati i autorizimit të amendamentuar është me kufizim deri më 31.05.2024 ndërkohë që aktiviteti është për furnizim 24 muaj. Shih paragrafin nga amendamenti i autorizimit: This amendment of the letter of authorization issued on the 11* of March 2024 shall be valid until 31* of May 2024. Sa i përket pretendimit për dëmtim të sigurimit të tenderit, në këtë aktivitet nuk është kërkuar sigurimi i tenderit, andaj nuk mund të konsiderohet si dëmtim sigurimi i tenderit siç është pretenduar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr.406/2024, i cili është dorëzuar me datë 17.05.2024.

Lidhur me pretendimet e OE “Flurim Nebija” B.I eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/406 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues me ofertë ka dorëzuar autorizimin nga prodhuesi i cili është i kufizuar në sasi dhe në periudhë kohore prej 82 ditëve kurse afati i kontratës sipas njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit ka qenë 24 muaj. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve / dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosje të tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale kishte aplikuar kërkesën si në vijim; Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i autorizuar nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga kompania-zyra përfaqësuese e prodhuesit. Dëshmia 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga kompania-zyra përfaqësuese e prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, web faqja etj, (për mundësi të verifikimit). Siç vërehet nga kërkesa e dosjes së tenderit, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. Në rastin konkret OE ankues me ofertë ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit, Hungarez “MEDIFOOD Internacional Trading”, mirëpo prodhuesi në autorizimin e dhënë kishte kufizuar, sasinë dhe afatin kohor të vlefshmërisë së autorizimit deri më 31.05.2024. Më tej eksperti shqyrtues sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Operatorit Ekonomik, përgatitja dhe dorëzimi i ofertës ashtu që të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK në dosjes së tenderit ka specifikuar se afati i kontratës është 24 muaj, çka nënkupton se autorizimi i kërkuar duhet ta mbulojë minimum periudhën e afatit të kontratës për të dëshmuar se i njëjti ka autorizim për furnizim me barnat e kërkuara tek aneksi 1 i dosjes së tenderit “Enteral solution” . Në rastin konkret edhe pse nuk ishte kërkuar që autorizimi të specifikohet nga sasia dhe afati kohor, prodhuesi e ka bërë një gjë të tillë duke e autorizuar OE ankues vetëm për sasinë prej 27.000.00 copë dhe në afat prej 82

ditëve të vlefshmërisë së tij. Me ç'rast konsideroj se komisioni i vlerësimit ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së, kur e ka refuzuar ofertën e OE ankues për shkak se autorizimi i tillë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse prodhuesi ka dhënë autorizim të kufizuar qoftë për nga sasia dhe afati kohor i vlefshmërisë së validitetit të autorizimit. Andaj, vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.

Konstatimi i dytë (II): Lidhur me pretendimin tjetër, Eksperti shqyrtues sqaron se konform nenit 64 paragrafi 64.2 i rregullores për prokurim publik nr.001/22 nuk mund të shqyrtoj pretendimin ankimor të paraqitur në ankesë për faktin se OE ankues nuk e ka paraqitur pretendimin e tillë në kërkesën për ri-shqyrtim të dorëzuar në autoritet kontraktues, pra i njëjti i ka ndryshuar pretendimet ankimore në Ankesën e dorëzuar në OSHP. Neni 64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues sipas autorizimit të datës 18.07.2024, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pa pasur nevojë për detaje tjera shtesë, konform mendimit të ekspertit shqyrtues konstaton se AK në dosje të tenderit, ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE ankues në ofertën e tij ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit, Hungarez "MEDIFOOD Internacional Trading", mirëpo prodhuesi në autorizimin e dhënë kishte kufizuar, sasinë dhe afatin kohor të vlefshmërisë së autorizimit deri me 31.05.2024. AK në dosjes së tenderit ka specifikuar se afati i kontratës është 24 muaj, çka nënkupton se autorizimi i kërkuar duhet ta mbulojë minimum periudhën e afatit të kontratës për të dëshmuar se i njëjti ka autorizim për furnizim me barnat e kërkuara tek aneksi 1 i dosjes së tenderit "Enteral solution". Në rastin konkret edhe pse nuk ishte kërkuar që autorizimi të specifikohet nga sasia dhe afati kohor, prodhuesi e ka bërë një gjë të tillë duke e autorizuar OE ankues vetëm për sasinë prej 27.000.00 copë dhe në afat prej 82 ditëve të vlefshmërisë së tij.

Paneli shqyrtues, mbi bazën e këtij sqarimi thekson se me të drejtë AK ka refuzuar ofertën e OE ankues pasi që Ankuesi nuk ka ofruar një autorizim valid të prodhuesit. “Sipas kërkesës në piken 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit, andaj paneli vlerëson se AK gjatë ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vlerëson se AK – komisioni i vlerësimit, ka respektuar nenin 59 dhe 60 të LPP-së, andaj është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-se, në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies.

Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminojë ose dëmtojë një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP nisët nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore, për të dy ankuesit.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Flurim Nebija B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: